

## **SHTOJCË 3 e**

### **Parashtrimet të përmbledhjes së korrigjuar sipas rregullës 86(3)(b)**

Publike

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

ELEMENTËT LIGJORË	REFERENCAT PËR PROVAT
<b>KRIMET</b>	
<b>Krime të luftës</b>	
<b>Elementët kontekstualë</b>	
(1) Konflikt i armatosur jondërkombëtar	<p>Konflikti midis UÇK-së dhe forcave serbe ishte në zhvillim e sipër gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza. Në gjysmën e parë të vitit 1999, komanda e UÇK-së urdhëroi mobilizim të përgjithshëm.<sup>1</sup></p> <p>Trupat jugosllave kishin kryer një ofensivë kundër UÇK-së në rajonin e Podujevës në Kosovë që nga dhjetori 1998.<sup>2</sup></p> <p>Komogllava në afërsi të Ferizajt (me përafërsisht 5.000 banorë) ishte shkatërruar 90% nga granatimet e 6 prillit 1999.<sup>3</sup></p> <p>Meshkujt që u përpoqën të largoheshin nga Mitrovica për në Shqipëri nga mesi i prillit 1999 u ndaluan nga forcat serbe dhe u mbajtën në ndalim para se t'i detyronin të ktheheshin në Mitrovicë. Ata u ndaluan në Skënderaj dhe meshkujt e moshës ushtarake u ndanë nga grupi. Këta meshkuj u mbajtën në një shkollë dhe në fund u transferuan në një burg në Smrekonicë. Në një moment, 50 meshkuj u çuan në vijën e frontit për t'u përdorur si mburojë e gjallë. Këta meshkuj rrëfyen për racione të pamjaftueshme ushqimi, rrahje, tortura dhe marrje në pyetje.<sup>4</sup></p>

<sup>1</sup> [REDAKTUAR]; Deklaratë Politike e UÇK-së nr.33, 25 mars 1999, SPOE00054441- SPOE00054442-ET; Vendim i UÇK-së nr.151, 31 maj 1999 “për mobilizim të përgjithshëm me qëllim konfrontimin e ofensivës serbe dhe çlirimin përfundimtar të Kosovës,” SPOE00054519- SPOE00054522-ET në 00054521-ET.

<sup>2</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 25 maj 1999, 075007-075129, f.52 (në ERN: 075058).

<sup>3</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 21 maj 1999, 075007-075129, f.36 (në ERN: 075042).

<sup>4</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 24 maj 1999, 075007-075129, f.42-43 (në ERN: 075048-075049).

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Më 12 maj 1999, rreth 4.000 refugjatë kaluan kufirin nga Kosova për në Shqipëri, të cilët raportuan për luftime të ashpra midis forcave serbe dhe UÇK-së.<sup>5</sup></p> <p>Më 15 maj “gjashtë persona [duke përfshirë dy gra dhe dy fëmijë] u qëlluan me armë zjarri nga milicë serbë gjatë ‘spastrimit’ të fshatit [në afërsi të Vitisë, në Kosovë].”<sup>6</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 17 maj 1999 thuhet se “të shtunën ushtria jugosllave ka vendosur postblloqe afër kufirit midis Malit të Zi dhe Shqipërisë ; raportohet se më shumë se 100 burra kosovarë janë arrestuar duke tentuar të kalojnë në Shqipëri ... në ditët e fundit, numri i tyre [i kosovarëve që po largohen për në Shqipëri] ka rënë ndjeshëm, megjithëse ata pak njerëz që kanë kaluar thanë se mijëra njerëz ishin ende në male, të cilëve po u mbaronte ushqimi dhe ishin nën trysinë e vazhdueshme të operacioneve ushtarake serbe ...”<sup>7</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 19 maj 1999 raportoheshin rrëfime të refugjatëve nga Kosova në Shqipëri: “Forcat serbe po i zbranznin fshatrat dhe okuponin shtëpitë e civilëve, si dhe i përdorin hambarët për të ruajtur armët e artillerisë dhe kundërajrore. Ata gjithashtu thanë se ushqimi po pakësohej.”<sup>8</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 21 maj 1999 thuhet se “ushtria dhe paramilitarët serbë kanë ndërmarrë një fushatë terrori dhe spastrimi etnik që përfshin rrahjen e civilëve, marrjen e parave dhe gjërave me vlerë të tyre, dhe djegien e shtëpive.”<sup>9</sup> I njëjti raport thekson intensifikimin e aktiviteteve ushtarake në Rozhajë.<sup>10</sup></p>
--	--

<sup>5</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 13 maj 1999, 075007-075129, f.1 (në ERN: 075007).

<sup>6</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 24 maj 1999, 075007-075129, f.44 (në ERN: 070050).

<sup>7</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 17 maj 1999, 074222-074225, f.1 (në ERN: 074222).

<sup>8</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 18 maj 1999, 075007-075129, f.20 (në ERN: 075026).

<sup>9</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 21 maj 1999, 075007-075129, f.36 (në ERN: 075042).

<sup>10</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 21 maj 1999, 075007-075129, f.37 (në ERN: 075043).

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 24 maj 1999 thuhet se mbi 18.000 refugjatë kanë kaluar nga Kosova në Shqipëri dhe në IRJ të Maqedonisë brenda një periudhe treditore, duke filluar nga 22 maji. Refugjatët raportuan se Komogllava ishte në duart e forcave serbe.<sup>11</sup></p> <p>Në Komunikatën e 26 majit 1999 të lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së thuhet: “ Siç është njoftuar opinioni, ushtria serbe, përveç se e ka zhvendosur me dhunë pjesën më të madhe të popullsisë kosovare, ajo në mënyrë të vazhdueshme e ka provokuar, duke e goditur me artileri dhe aviacion atë pjesë të kësaj popullsie që është vendosur përkohësisht në rrethet e Kukësit, Hasit e Tropojës në Shqipëri. Si rrjedhojë e këtyre goditjeve të herëpashershme, popullsia e atjeshme ka pësuar vrasje, plagosje dhe keqtrajtime të tjera. Në këto kushte, për ta pamundësuar ushtrinë serbe të vrasë popullsinë e zhvendosur në Shqipëri, në afërsi të kufirit politik-shtetëror, UÇK planifikoi, organizoi dhe ndërmori operacionin sulmues, të quajtur “Shigjeta” me detyrë: asgjësimin e forcave serbe të dislokuara në afërsi të brezit kufitar me Shqipërinë dhe pastrimin e këtij brezi nga ushtria serbe.</p> <p>Ky operacion është ndërmarrë në koordinim me forcat e Zonës Operative të Pashtrikut dhe njësisive autonome të Shtabit të Përgjithshëm, të organizuara si forca të destinuar për veprime të veçanta (FDVV). Operacioni sulmues “Shigjeta” filloi sot, më 26 maj 1999, në orën 4, dhe po zhvillohet me sukses. Deri në orët e mesditës së sotme, forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë marrë nën kontroll malin Pashtrik dhe pjerrësitë veriore të tij në fshatin Milaj, pastaj kanë asgjësuar disa posta kufitare. Po vazhdojnë luftimet për pastrimin e tërë brezit kufitar me Shqipërinë, duke mësyre gjithnjë e më në thellësi të territorit të Kosovës. Si rrjedhojë e luftimeve të deritashme, armikut i janë vrarë 20 ushtarë dhe i janë kapur rob dy të tjerë, si dhe teknikë dhe armatim i shumtë, të dalë jashtë luftimit. Nga forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është një i vrarë dhe dy të plagosur. Operacioni po vazhdon.”<sup>12</sup></p>
--	---

<sup>11</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 24 maj 1999, 075007-075129, f.43-44 (në ERN: 075049-070050).

<sup>12</sup> Komunikata nr. 79 e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, 26 maj 1999, SPOE00055399-SPOE00055399-ET.

## Publike

## Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 28 maj 1999 thuhet se: “Llogaritet që numri i refugjatëve dhe personave të zhvendosur në rajon është 778.700 persona, ku përfshihen ... 441.000 në Shqipëri... Rreth 400 refugjatë kanë hyrë në Shqipëri në pikën kufitare të Morinës të enjten, nën zjarrin e snajperëve dhe shpërthimeve të artillerisë në anën kosovare të kufirit ... Të mërkurën, disa fshatarë u vranë dhe disa të tjerë u plagosën nga predhat e artillerisë që ranë në Krumë nga kufiri me Kosovën. Po kështu, edhe një gazetar u godit nga zjarri i një arme snajper në Morinë.”<sup>13</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 31 maj 1999 raportohet për luftime të ashpra dhe të vazhdueshme midis forcave serbe dhe UÇK-së, përfshirë përleshje të ashpra në kufirin shqiptar gjatë javës së mëparshme, dhe theksohet një prani më e madhe e UÇK-së në rajonet e Kukësit dhe Hasit në Shqipëri.<sup>14</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 1 qershor 1999 raportohet për vazhdimin e përleshjeve midis UÇK-së dhe forcave serbe. Refugjatë nga Gjilani [sic] rrëfyan për “shtim të konsiderueshëm të maltretimeve dhe dëbimeve të kosovarëve, duke përfshirë ndalimin e djemve të rinj dhe shënjestrimin e intelektualëve.” Ata thanë se serbët refuzonin t’i pranonin shqiptarët e lënduar nëpër spitale, të cilat ishin të mbushura me policë dhe ushtarë të plagosur serbë.<sup>15</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 2 qershor 1999 raportohet për luftime intensive midis forcave serbe dhe UÇK-së, si edhe për gjuajtjet prej forcave serbe të pozicioneve të UÇK-së në Krumë, Shqipëri.<sup>16</sup></p>
--	---

<sup>13</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 28 maj 1999, 074226-074231, f.1 (në ERN: 074226).

<sup>14</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 31 maj 1999, 075007-075129, f.72-73 (në ERN: 075078-075079).

<sup>15</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 1 qershor 1999, 075007-075129, f.81-83 (në ERN: 075087-075089).

<sup>16</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 2 qershor 1999, 075007-075129, f.90-91 (në ERN: 075096-075097).

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 3 qershor 1999 thuhet se aktivitetet luftarake përgjatë kufirit janë duke vazhduar dhe se policia serbe po gjuan kundër civilëve dhe po i ndan meshkujt nga kolonat e refugjatëve.<sup>17</sup></p> <p>Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 8 qershor 1999 thuhet se me dhjetëra predha mortajash dhe granatahedhësish të gjuajtura nga Kosova goditën fshatin Vratnicë të Maqedonisë. Refugjatët nga Kosova raportuan për vazhdimin e fushatës së spastrimit etnik nga ana e forcave serbe, pavarësisht marrëveshjes për një plan të paqes në Kosovë, të arritur disa ditë më parë.<sup>18</sup></p> <p><b>LIDHJA</b></p> <p>Një numër i madh refugjatësh shqiptarë kosovarë qëndruan në Kukës gjatë periudhës që mbulon Aktakuza. Në Raportin e përditësuar të UNHCR-së për krizën në Kosovë të datës 17 maj 1999 përmendet se “ende rreth 30.000 refugjatë” jetonin në kampet me tenda në Kukës në atë kohë.<sup>19</sup></p> <p>Përveç pranisë së një numri të madh refugjatësh që ishin larguar nga Kosova për shkak të konfliktit, në Kukës vepronte edhe UÇK-ja gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza:</p> <p>Operacionin “Shigjeta” e drejtoi anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së Bislim Zyrapi, i cili e kishte bazën kryesisht në një shtab të UÇK-së në Kukës. Ky i fundit gjithashtu i furnizonte me armë dhe municion batalionet që zbatonin Operacionin “Shigjeta”.<sup>20</sup></p>
--	---

<sup>17</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 3 qershor 1999, 075007-075129, f.98-100 (në ERN: 075104-075106).

<sup>18</sup> UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 8 qershor 1999, 075007-075129, f.115-117 (në ERN: 075121-075123).

<sup>19</sup> *Shih p.sh.* UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë: 17 maj 1999, 074222-074225, f.1 (në ERN: 074222); UNHCR, Raport i Përditësuar për Krizën në Kosovë, 13 maj 1999, 21 maj 1999, 27 maj 1999, 074222-074225, f.2, 35, 66 (në ERN-të: 075008, 075041, dhe 075074).

<sup>20</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Një fabrikë jashtë përdorimit (“fabrika e metalit në Kukës”)<sup>21</sup> u përdor si shtab i UÇK-së nga fillimi i prillit<sup>22</sup> e deri në fund të luftës, për të mbështetur operacionet luftarake në Kosovë. Ky objekt përdorej si vend për rekrutimin<sup>23</sup> dhe regjistrimin e ushtarëve; magazinimin e veshjeve, armëve dhe pajisjeve për ushtrinë;<sup>24</sup> dhe përgatitjet logjistike për operacionet luftarake brenda në Kosovë.<sup>25</sup> Objekti përfshinte zyra për oficerët e UÇK-së,<sup>26</sup> hapësira për magazinim, mjedise për fjetje,<sup>27</sup> dhe dhoma që përdoreshin për mbajtje në ndalim.<sup>28</sup> Ushtarë të UÇK-së arrinin rregullisht në fabrikën e metalit në Kukës, ku qëndronin deri në mobilizimin dhe transferimin e tyre<sup>29</sup> ose në pika të UÇK-së që ishin më afër vijës së frontit, ose në objekte të stërvitjes së UÇK-së.<sup>30</sup> Personeli i UÇK-së në fabrikën e metalit në Kukës ishte përgjegjës për mobilizimin e ushtarëve, sigurimin e funksionimit të armëve, dhe sigurimin e automjeteve për transportimin e ushtarëve.<sup>31</sup> Anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së vinin rregullisht në fabrikën e metalit në Kukës.<sup>32</sup> Ushtarët e UÇK-së që ishin plagosur në luftime ktheheshin në fabrikën e metalit në Kukës, dhe ndonjëherë ushtarë të UÇK-së të vrarë në luftime varroseshin me nderime ushtarake në varrezat e Kukësit.<sup>33</sup></p>
--	--

---

<sup>21</sup> [REDAKTUAR]

<sup>22</sup> [REDAKTUAR]

<sup>23</sup> [REDAKTUAR]

<sup>24</sup> [REDAKTUAR]

<sup>25</sup> [REDAKTUAR]

<sup>26</sup> [REDAKTUAR]

<sup>27</sup> [REDAKTUAR]

<sup>28</sup> [REDAKTUAR]

<sup>29</sup> [REDAKTUAR]

<sup>30</sup> [REDAKTUAR]

<sup>31</sup> [REDAKTUAR]

<sup>32</sup> [REDAKTUAR]

<sup>33</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

(2) Dijenia për rrethanat faktike të konfliktit të armatosur	<p><b>Pjetër SHALA</b>, me pseudonimin “<i>Ujku</i>”,<sup>34</sup> ishte anëtar i UÇK-së.<sup>35</sup> Gjatë kohës që ishte në Belgjikë në fillim të vitit 1999, ai mësoi se “komanda e UÇK-së kishte urdhëruar mobilizim të përgjithshëm” dhe pas kësaj ai hyri përsëri në Kosovë së bashku me të tjerë të cilët gjithashtu do të anëtarësoheshin në UÇK.<sup>36</sup> Ai ishte në Kukës<sup>37</sup> në bazë të asaj që ai besonte se ishte urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për të udhëhequr Brigadën 128 të UÇK-së në luftimet kundër forcave të RFJ-së.<sup>38</sup></p> <p>[REDAKTUAR] ka përshkruar një incident kur Sabit GEÇI, me pseudonimin “<i>Qopa</i>”,<sup>39</sup> Xhemshit KRASNIQI, <b>Pjetër SHALA</b><sup>40</sup> dhe tre policë ushtarakë ishin në dhomën e tij, dhe ushtarë që kishin ardhur nga vija e frontit për të sjellë në Kukës një shok të plagosur lufte, u rrahën mizorisht nën akuzat se e kishin braktisur vijën e frontit.<sup>41</sup></p>
<b>Elementë të Pikave Bazë</b>	
<b>Pika 1: Ndalim Arbitrar (neni 14(1)(c)/ neni 14(1)(c)(i))</b>	
(1) Heqja e lirisë së një individi pa proces të rregullt ligjor	Civilë u mbajtën në ndalim në fabrikën e metalit në Kukës, duke përfshirë gjatë periudhës afërsisht ndërmjet 17 majit dhe 5 qershorit 1999. <sup>42</sup> Askush prej të ndaluarve nuk u informua për cilin veprim ose sjellje kriminale të pretenduar ishte arrestuar, <sup>43</sup> nuk u akuzua zyrtarisht e as u nxor para një gjyqi për t’u gjykuar për veprimtari kriminale.

<sup>34</sup> [REDAKTUAR]<sup>35</sup> [REDAKTUAR]<sup>36</sup> [REDAKTUAR]<sup>37</sup> [REDAKTUAR]<sup>38</sup> [REDAKTUAR]<sup>39</sup> [REDAKTUAR]<sup>40</sup> [REDAKTUAR]<sup>41</sup> [REDAKTUAR]<sup>42</sup> [REDAKTUAR]<sup>43</sup> [REDAKTUAR]



Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>[REDAKTUAR] ka përshkruar se si pas arrestimit të tij [REDAKTUAR], ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b>, e çuan në fabrikën e metalit në Kukës.<sup>44</sup> Kur mbërriti në fabrikën e metalit në Kukës (nga një qendër tjetër ndalimi e UÇK-së), atë e mbajtën me roje, dhe pas marrjes në pyetje, e futën në një vend të improvizuar ndalimi [REDAKTUAR] ku gjeti [REDAKTUAR] i cili në atë kohë mbahej në ndalim. [REDAKTUAR] ishte ndaluar pasi ushtarët e UÇK-së ia patën marrë paratë dhe pasaportën kur kishte mbërritur në Durrës.<sup>45</sup></p> <p>Në fabrikën e metalit në Kukës, të ndaluarve ua hoqën lirinë, ndër të tjera duke i mbajtur me roje nëpër qeli të improvizuara;<sup>46</sup> duke i nxjerrë nga dhoma për në nevojtoare me përcjellje;<sup>47</sup> duke ua lidhur duart me pranga.<sup>48</sup></p> <p>[REDAKTUAR] nuk lejohej të dilte nga dhoma përveçse për të shkuar në nevojtoare.<sup>49</sup> Gjatë gjithë kohës së mbajtjes në ndalim, duart e [REDAKTUAR] ishin gjithmonë të lidhura.<sup>50</sup></p> <p>[REDAKTUAR] deklaroi se UÇK-ja sillte njerëz “të marrë nga qyteti ose fshati” në qendra ndalimi, ndër të cilat fabrika e metalit në Kukës, ku ai mund t’i shihte nga dritarja, dhe nxori përfundimin se ata ishin të burgosur (në krahasim me, për shembull, të lënduar për shkak të luftës) në bazë të mënyrës si i trajtonin: “Mund ta thuash këtë me të parë dikë të mbuluar në gjak, që e mbajnë për krahu dhe që mezi ecën ...”<sup>51</sup></p>
--	---

---

<sup>44</sup> [REDAKTUAR]

<sup>45</sup> [REDAKTUAR]

<sup>46</sup> [REDAKTUAR]

<sup>47</sup> [REDAKTUAR]

<sup>48</sup> [REDAKTUAR]

<sup>49</sup> [REDAKTUAR]

<sup>50</sup> [REDAKTUAR]

<sup>51</sup> [REDAKTUAR]

## Publike

## Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

(2) Synimi i heqjes së lirisë së një individi pa proces të rregullt ligjor ose dijenia e arsyeshme se veprimi ose mosveprimi me gjasë do të shkaktojë heqje arbitrare të lirisë.	Synimi i <b>Pjetër SHALËS</b> mund të deduktohet nga mënyra e qëllimshme në të cilën të ndaluarit sillleshin, mbaheshin, trajtoheshin dhe liroheshin nga fabrika e metalit në Kukës. <sup>52</sup> Fakti që <b>Pjetër SHALA</b> paraprakisht në vitin 1998 kishte shërbyer në UÇK si anëtar i Policisë Ushtarake të UÇK-së <sup>53</sup> përbën një arsye shtesë për deduktimin e synimit të tij nga moszbatimi prej tij i procedurave të rregullta të ndalimit.
(3) Viktima është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	Të gjitha viktimat u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës. <sup>54</sup>  [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] mbërritën në fabrikën e metalit në Kukës si civilë që kërkonin të anëtarësoheshin në UÇK. Në kohën e ndalimit të tyre, ata ende nuk ishin anëtarësuar. <sup>55</sup> [REDAKTUAR] të ndaluarit nuk merrnin pjesë aktive në luftime; <sup>56</sup> ata ishin [REDAKTUAR]. <sup>57</sup> [REDAKTUAR]. <sup>58</sup> [REDAKTUAR] sa kishte zbritur nga trageti nga Italia në kohën kur u arrestua. <sup>59</sup> Ndër të ndaluarit e tjerë në fabrikën e metalit në Kukës ishin [REDAKTUAR]” dhe [REDAKTUAR]. <sup>60</sup>
(4) Dijenia se viktima është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	Kryesit, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b> , ishin pjesëmarrës dhe në dijeni të ndalimit të viktimave dhe/ose rrethanave të arrestimit të tyre. <sup>61</sup>  Kur <b>Pjetër SHALA</b> e takoi për herë të parë [REDAKTUAR] po transferohej nga një automjet i UÇK-së në një tjetër, gjë që e bënte të dukshme për <b>Pjetër SHALËN</b> (i cili ishte në automjetin

<sup>52</sup> Shih materialin e cituar nën Pikën 1, elementi 1, dhe Pikat 2-3.

<sup>53</sup> [REDAKTUAR]

<sup>54</sup> Shih materialin e cituar në lidhje me Pikën 1, elementi 1. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR]

<sup>55</sup> [REDAKTUAR]

<sup>56</sup> [REDAKTUAR]

<sup>57</sup> [REDAKTUAR]

<sup>58</sup> [REDAKTUAR]

<sup>59</sup> [REDAKTUAR]

<sup>60</sup> [REDAKTUAR]

<sup>61</sup> Shih materialin e cituar nën Pikën 1, elementi 1.

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>e dytë së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së) se [REDAKTUAR] nuk merrte pjesë aktive në luftime, së paku nga ai moment e më tutje.<sup>62</sup> [REDAKTUAR],<sup>63</sup> [REDAKTUAR].<sup>64</sup></p> <p><b>SHALA</b> e pa [REDAKTUAR] në fabrikën e metalit në Kukës [REDAKTUAR], kështu që <b>SHALA</b> duhet të ketë parë se [REDAKTUAR] nuk merrte pjesë aktive në luftime.<sup>65</sup> [REDAKTUAR].<sup>66</sup> Gjatë asaj kohe, [REDAKTUAR] nuk ishin të armatosur dhe po prisnin regjistrimin/anëtarësimin e tyre në UÇK.<sup>67</sup></p>
<b>Pika 2: Trajtim Mizor (neni 14(1)(c)(i))</b>	
(1) Veprim ose mosveprim që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose përbën cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.	<p>Gjatë kohës që [REDAKTUAR] dhe civilë të tjerë mbaheshin në ndalim nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b>, në fabrikën e metalit në Kukës midis 18 majit dhe 5 qershorit 1999, ndodhën ngjarjet e mëposhtme:</p> <p>Anëtarët e UÇK-së i rrihnin të ndaluarit pothuajse çdo ditë ose natë.<sup>68</sup> [REDAKTUAR] u “rrahën ditë e natë për një muaj” derisa trupat e tyre u nxinë.<sup>69</sup> [REDAKTUAR] nuk lejohej të dilte nga dhoma ku mbahej, përveçse për të shkuar në nevojtoje.<sup>70</sup> Gjatë gjithë kohës që ishte i ndaluar, duart e [REDAKTUAR] ishin gjithmonë të lidhura.<sup>71</sup></p>

---

<sup>62</sup> [REDAKTUAR]<sup>63</sup> [REDAKTUAR]<sup>64</sup> [REDAKTUAR]<sup>65</sup> [REDAKTUAR]<sup>66</sup> [REDAKTUAR]<sup>67</sup> [REDAKTUAR]<sup>68</sup> [REDAKTUAR]<sup>69</sup> [REDAKTUAR]<sup>70</sup> [REDAKTUAR]<sup>71</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Një i ndaluar i ka përshkruar rrahjet që <b>Pjetër SHALA</b> u bëri një grupi të ndaluarish [REDAKTUAR]: “I rrahu aq keq sa që u shkatërruan ... I rreshtonte në oborr dhe i rrihte.”<sup>72</sup> Një i ndaluar nga [REDAKTUAR] u rrah deri në atë pikë sa që kur [REDAKTUAR] ia hoqi teshat, “lëkura iu shkul bashkë me fanellën apo xhemperin.”<sup>73</sup></p> <p>Si rezultat i trajtimit të tyre, të ndaluarit u traumatizuan rëndë psiqikisht dhe fizikisht.<sup>74</sup> [REDAKTUAR] iu thyen brinjët [REDAKTUAR], kurse kërcin e këmbës ia theu Xhemshit KRASNIQI duke i rënë me shufër hekuri.<sup>75</sup> Një e ndaluar u rrah aq keq [REDAKTUAR].<sup>76</sup> [REDAKTUAR] pësoi pasoja afatgjata nga keqtrajtimi.<sup>77</sup> Ai deklaroi: “Kam parë vdekjen me sy. Nuk ka gjë që nuk përjetova.”<sup>78</sup></p> <p>Një i ndaluar, [REDAKTUAR], vdiq si pasojë e keqtrajtimit që iu bë. (<i>shih</i> Pika 4: Vrasje e paligjshme, më poshtë).</p> <p>Të ndaluarit civilë iu nënshtruan kushteve çnjerëzore të ndalimit prej anëtarëve të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b>. Ata flinin mbi një dysheme të fortë dhe të pistë betoni.<sup>79</sup> Në të vërtetë, nuk u lejohej të përdornin asgjë, madje as teshat e veta, në vend të jastëkut.<sup>80</sup> Nuk kishin ushqim<sup>81</sup> dhe kujdes mjekësor të mjaftueshëm,<sup>82</sup> e as ujë për t’u larë e pastruar.<sup>83</sup> Në</p>
--	--

---

<sup>72</sup> [REDAKTUAR]<sup>73</sup> [REDAKTUAR]<sup>74</sup> [REDAKTUAR]<sup>75</sup> [REDAKTUAR]<sup>76</sup> [REDAKTUAR]<sup>77</sup> [REDAKTUAR]<sup>78</sup> [REDAKTUAR]<sup>79</sup> [REDAKTUAR]<sup>80</sup> [REDAKTUAR]<sup>81</sup> [REDAKTUAR]<sup>82</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu*, elementi 1 i Pikës 2.<sup>83</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>një vend të mbajtjes në ndalim, dyshemeja ishte e mbushur me shishe plot me urinë.<sup>84</sup> [REDAKTUAR] humbi 14-17 kilogramë gjatë kohës që u mbajt në ndalim.<sup>85</sup></p> <p>Në dhomat ku mbaheshin të ndaluarit nuk merrej dot frymë nga i nxehti, dhe nga kjo [REDAKTUAR] ndonjëherë i binte të fikët.<sup>86</sup> Disa të ndaluar [REDAKTUAR] i detyruan të punonin për anëtarët e UÇK-së, duke pastruar nevojtoret dhe ngarkuar e shkarkuar kamionët.<sup>87</sup> Rrugës për në nevojtores, të ndaluarit ngacmoheshin nga një anëtar i UÇK-së i cili provonte t'i shponte me thikë; si rezultat i kësaj, të ndaluarit mundoheshin të mos pinin lëngje në mënyrë që të shmangnin nevojën për të shkuar në nevojtores.<sup>88</sup></p> <p><b>Më 20 maj 1999 ose rreth kësaj date</b></p> <p>Në mbrëmjen e 20 majit 1999, ose rreth kësaj date,<sup>89</sup> ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b> dhe Xhemshit KRASNIQI, morën në pyetje, torturuan dhe keqtrajtuat [REDAKTUAR] të ndaluar civilë, [REDAKTUAR].</p> <p>[REDAKTUAR] e sollën nga një qeli e improvizuar ndalimi ku ishte mbajtur disa ditë, në një zyrë në katin përdhes të së njëjtës ndërtesë në vendndodhjen e fabrikës së metalit në Kukës.<sup>90</sup> Xhemshit KRASNIQI urdhëroi <b>Pjetër SHALËN</b> që t'i binte [REDAKTUAR] “50 herë në duar me shkopin e gomës ...” <b>Pjetër SHALA</b> urdhëroi [REDAKTUAR] që t'i binte [REDAKTUAR] me shkopin e gomës, por [REDAKTUAR] refuzoi dhe më pas “e rrahën – e kapën [REDAKTUAR] atë që u vra, dhe e rrahën. I ranë me grushte, me shkelma, e rrahën me shkop gome, me shkop bejsbolli, derisa u lodhën.”<sup>91</sup> <b>Pjetër SHALA</b> e rrahu</p>
--	--

<sup>84</sup> [REDAKTUAR]<sup>85</sup> [REDAKTUAR]<sup>86</sup> [REDAKTUAR]<sup>87</sup> [REDAKTUAR]<sup>88</sup> [REDAKTUAR]<sup>89</sup> [REDAKTUAR]<sup>90</sup> [REDAKTUAR]<sup>91</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>[REDAKTUAR] me shkop bejsbolli “në kokë, në gjoks, edhe në shpinë, dhe gjithashtu ia theu brinjët [REDAKTUAR] ... Ai [SHALA] ... i tha [REDAKTUAR] ‘Rrihe këtë serb’... pastaj Xhemshiti e kapi [REDAKTUAR], dhe Pjetër SHALA e shtyu [REDAKTUAR] mbi një stol... Dhe pastaj filluan t’i binin [REDAKTUAR] shputave të këmbëve për aq gjatë sa mundën...”<sup>92</sup> Një ushtar i UÇK-së me kokë të rruar i ra me shkelm dhe ia theu dhëmbët [REDAKTUAR].<sup>93</sup> Personat që e mbanin të ndaluar i thanë që ishte “dënuar me burg dhe ekzekutim.”<sup>94</sup></p> <p>[REDAKTUAR] u çua në një “zyrë” ku pa [REDAKTUAR] “duke u torturuar.”<sup>95</sup> Ai e pa [REDAKTUAR] të ulur në një karrige të mbuluar në gjak. Ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b>, e goditën në kokë me shkopinj druri të mbështjellë me fashë.<sup>96</sup></p> <p>Në zyrë, anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b>,<sup>97</sup> e rrahën [REDAKTUAR] me shkopinj,<sup>98</sup> shufra hekuri, armë, objekte të mprehta dhe thika.<sup>99</sup> Ata i thanë [REDAKTUAR] që ta godiste [REDAKTUAR].<sup>100</sup></p> <p><b>Pjetër SHALA</b> dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së rrahën [REDAKTUAR] aq mizorisht sa që ai humbi vetëdijen. Kur iu tha gjaku në flokë dhe preku flokët me dorë, [REDAKTUAR] “iu duk sikur flokët ishin - ishin duke u thyer.”<sup>101</sup> Gjatë kohës që ishte pa vetëdije, anëtarët e UÇK-së i hodhën ujë.<sup>102</sup> E shpuan me thikë në fyt në korridorin jashtë dhomës ku u kryen</p>
--	---

<sup>92</sup> [REDAKTUAR]<sup>93</sup> [REDAKTUAR]<sup>94</sup> [REDAKTUAR]<sup>95</sup> [REDAKTUAR]<sup>96</sup> [REDAKTUAR]<sup>97</sup> [REDAKTUAR]<sup>98</sup> [REDAKTUAR]<sup>99</sup> [REDAKTUAR]<sup>100</sup> [REDAKTUAR]<sup>101</sup> [REDAKTUAR]<sup>102</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>rrahjet.<sup>103</sup> Sipas [REDAKTUAR], <b>Pjetër SHALA</b> “ishte goxha trupmadh, i fortë, i fuqishëm, dhe u binte njerëzve në një mënyrë – në një mënyrë si u bien njerëzit kafshëve, por nuk sillen ashtu me njerëz të tjerë. Nuk rrihen njerëzit në atë mënyrë.”<sup>104</sup> Gjatë një keqtrajtimi tjetër ku ishte i pranishëm <b>Pjetër SHALA</b>, [REDAKTUAR] e detyruan të pinte ujë; i hodhën kripë në sytë dhe plagët; dhe i hodhën uthull në plagët dhe prerjet që i kishte nëpër trup.<sup>105</sup></p> <p>Gjithashtu, anëtarët e UÇK-së ia mbuluan kokën [REDAKTUAR] me një qese najloni dhe ia shtinë në një legen me ujë deri sa nuk mund të merrte më frymë,<sup>106</sup> dhe e kërcënuan se do të shtinin me armë zjarri në të.<sup>107</sup></p> <p>Anëtarët e UÇK-së rrahën edhe [REDAKTUAR] në të njëjtën mënyrë si të ndaluarit e tjerë.<sup>108</sup> Të ndaluarit u rrahën aq keq sa “edhe teshat u bënë qull në gjak.”<sup>109</sup></p> <p><b>Pjetër SHALA</b> dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së rrahën [REDAKTUAR].<sup>110</sup> I ranë në duar,<sup>111</sup> kurse Xhemshit KRASNIQI i ra hundës me shkop gome. Anëtarët e UÇK-së gjithashtu [REDAKTUAR] shtinë këmbët në ujë të ftohtë dhe një ushtar e kërcënoi se do [REDAKTUAR] gdhendte në gjoks një kryq me thikën që kishte.<sup>112</sup> [REDAKTUAR] pa një anëtar të UÇK-së duke u orvatur të vizatonte me thikë një kryq në gjoksin e [REDAKTUAR].<sup>113</sup></p>
--	---

---

<sup>103</sup> [REDAKTUAR]<sup>104</sup> [REDAKTUAR]<sup>105</sup> [REDAKTUAR]<sup>106</sup> [REDAKTUAR]<sup>107</sup> [REDAKTUAR]<sup>108</sup> [REDAKTUAR]<sup>109</sup> [REDAKTUAR]<sup>110</sup> [REDAKTUAR]<sup>111</sup> [REDAKTUAR]<sup>112</sup> [REDAKTUAR]<sup>113</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>[REDAKTUAR] e pa [REDAKTUAR] në një “gjendje katastrofike. Nuk lëvizte dot...Ishte krejtësisht i mbuluar në gjak”, kur [REDAKTUAR] hyri në zyrën ku ishin të pranishëm <b>Pjetër SHALA</b>, Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe të tjerë. [REDAKTUAR] pa [REDAKTUAR] teksa po rrihej, dhe pa që i hodhën kripë në sytë dhe plagët.<sup>114</sup> [REDAKTUAR] e rrihnin me shkop bejsbolli dhe shufër metali.<sup>115</sup></p> <p>Gjatë këtij rasti, anëtarët e UÇK-së rrahën me duar e këmbë edhe dy të ndaluara femra.<sup>116</sup></p> <p><b>Më [REDAKTUAR] 1999 ose rreth kësaj date</b> Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b> dhe tregoi nga KRASNIQI, rrahën [REDAKTUAR].<sup>117</sup> [REDAKTUAR].<sup>118</sup> [REDAKTUAR]<sup>119</sup> [REDAKTUAR].<sup>120</sup> [REDAKTUAR].<sup>121</sup></p> <p><b>Më 4 qershor 1999 ose rreth kësaj date</b> Rreth datës 4 qershor, anëtarë të UÇK-së përsëri i veçuan [REDAKTUAR] për t'i keqtrajtuar. <b>Pjetër SHALA</b>, Sabit GEÇI, Xhemshit KRASNIQI dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i rrahën [REDAKTUAR], ndër të tjera me shufra metali, shkopinj bejsbolli dhe armë.<sup>122</sup> Ata kishin një pajisje incizuese për të incizuar deklaratat pranuese.<sup>123</sup></p>
--	---

<sup>114</sup> [REDAKTUAR]<sup>115</sup> [REDAKTUAR]<sup>116</sup> [REDAKTUAR]<sup>117</sup> [REDAKTUAR]<sup>118</sup> [REDAKTUAR]<sup>119</sup> [REDAKTUAR]<sup>120</sup> [REDAKTUAR]<sup>121</sup> [REDAKTUAR]<sup>122</sup> [REDAKTUAR]<sup>123</sup> [REDAKTUAR]



Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Anëtarët e UÇK-së i qëlluan [REDAKTUAR] me armë zjarri nga afër.<sup>124</sup> [REDAKTUAR].<sup>125</sup> [REDAKTUAR]<sup>126</sup> Të dy u rrahën pasi ishin qëlluar me armë zjarri.<sup>127</sup> [REDAKTUAR].<sup>128</sup></p> <p>Pas rrahjeve dhe gjuajtjes me armë zjarri, anëtarët e UÇK-së e çuan [REDAKTUAR] në një dhomë ku mbahej [REDAKTUAR].<sup>129</sup> [REDAKTUAR] kishte një vrimë plumbi [REDAKTUAR] dhe ishte i mbuluar në gjak.<sup>130</sup> Pasi [REDAKTUAR]<sup>131</sup></p> <p>[REDAKTUAR] “vuajti pothuajse 24 orë dhe vdiq në mëngjes.”<sup>132</sup> Megjithëse kërkoi t’i sillnin mjek, [REDAKTUAR] u vizitua nga personeli mjekësor vetëm para se të vdiste.<sup>133</sup> “Mjeku kërkoi që ta sillnin - ta çonin në spital në Kukës, dhe ata nuk e çuan – nuk u pajtuan.”<sup>134</sup> [REDAKTUAR]<sup>135</sup> [REDAKTUAR] vdiq me kokën mbështetur te [REDAKTUAR].<sup>136</sup> Anëtarët e UÇK-së “e nxorën duke e tërhequr zhagas, sikurse nxirret zhagas një qen nga dhoma.”<sup>137</sup></p>
--	--

---

<sup>124</sup> [REDAKTUAR]

<sup>125</sup> [REDAKTUAR]

<sup>126</sup> [REDAKTUAR]

<sup>127</sup> [REDAKTUAR]

<sup>128</sup> [REDAKTUAR]

<sup>129</sup> [REDAKTUAR]

<sup>130</sup> [REDAKTUAR]

<sup>131</sup> [REDAKTUAR]

<sup>132</sup> [REDAKTUAR]

<sup>133</sup> [REDAKTUAR]

<sup>134</sup> [REDAKTUAR]

<sup>135</sup> [REDAKTUAR]

<sup>136</sup> [REDAKTUAR]

<sup>137</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>Pas vdekjes [REDAKTUAR], një anëtar i UÇK-së i ra [REDAKTUAR] me shkelm në kokë [REDAKTUAR].<sup>138</sup> Sabit GECI e rrahu [REDAKTUAR] përsëri, [REDAKTUAR]<sup>139</sup> Një anëtar tjetër i UÇK-së iu drejtua të ndaluarve, përfshirë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], dhe u tha, “Me ju të tre do të merrem sonte.”<sup>140</sup></p> <p><i>Shih gjithashtu, provat në elementin 1 të <b>Pikës 1.</b></i></p>
<p>(2) Synimi për të shkaktuar lëndim të rëndë fizik ose mendor, ose për të kryer cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor të viktimës.</p>	<p>Synimi i <b>Pjetër SHALËS</b> duket qartë nga pjesëmarrja aktive e tij në keqtrajtimin e të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës,<sup>141</sup> dhe ndryshe, nga mosmarrja prej tij e masave të nevojshme për garantimin e kushteve njerëzore të mbajtjes në ndalim. Gjithashtu, ai urdhëroi një të ndaluar që të rrihte një të ndaluar tjetër<sup>142</sup> dhe i urdhëroi të ndaluarit që të shkarkonin pajisje nga kamionët.<sup>143</sup></p> <p><b>Pjetër SHALA</b> duhet të ketë qenë në dijeni të lëndimeve të rënda që u shkaktoheshin të ndaluarve, dhe prapëseprapë vazhdoi t'i keqtrajtonte. Të ndaluarit ishin dukshëm të lënduar<sup>144</sup> dhe ndonjëherë gjatë rrahjeve humbnin vetëdijen.<sup>145</sup></p> <p>[REDAKTUAR]<sup>146</sup></p>
<p>(3) Viktima është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.</p>	<p><i>Shih më lart, elementi 3 i <b>Pikës 1.</b></i></p>

<sup>138</sup> [REDAKTUAR]<sup>139</sup> [REDAKTUAR]<sup>140</sup> [REDAKTUAR]<sup>141</sup> *Shih më lart, elementi 1 i Pikës 2.* [REDAKTUAR]<sup>142</sup> [REDAKTUAR]<sup>143</sup> [REDAKTUAR]<sup>144</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* materialin e referuar në Pikën 2, elementi 1, më lart.<sup>145</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* materialin e referuar në Pikën 2, elementi 1, më lart.<sup>146</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

(4) Dijenia se viktimja është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	<i>Shih më lart, elementi 4 i Pikës 1.</i>
<b>Pika 3: Torturë (neni 14(1)(c)(i))</b>	
(1) Shkaktimi, me anë të veprimit ose mosveprimit, i dhimbjes ose vuajtjes së rëndë, qoftë fizike apo mendore.	<i>Shih më lart, elementi (1) për Pikën 2.</i>
(2) Me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, apo ndëshkimin, frikësimin ose shtrëngimin e viktimës ose personit të tretë, ose diskriminimin mbi çfarëdo baze të viktimës apo personit të tretë.	<p><b>Pjetër SHALA</b> mori pjesë aktive në periudhat e torturimit gjatë të cilave anëtarët e UÇK-së akuzonin, merrnin në pyetje dhe ndëshkonin të ndaluarit, ndërkohë që i keqtrajtonin mizorisht. Shpesh herë gjatë rrahjeve anëtarët e UÇK-së merrnin me vete pajisje për incizim për të incizuar deklaratat pranuese.<sup>147</sup></p> <p>Rrahjet [REDAKTUAR] kishin për qëllim marrjen e deklaratave pranuese prej tyre.<sup>148</sup> Në momentin kur [REDAKTUAR] u qëllua për vdekje, [REDAKTUAR] u bënin pyetje ndërsa i incizonin.<sup>149</sup></p> <p>[REDAKTUAR].<sup>150</sup></p> <p>[REDAKTUAR] dëgjoi anëtarët e UÇK-së duke e akuzuar [REDAKTUAR] se nëna i flinte me forca serbe, përfshirë forcat e Arkanit.<sup>151</sup> [REDAKTUAR].<sup>152</sup></p>

<sup>147</sup> [REDAKTUAR]<sup>148</sup> [REDAKTUAR]<sup>149</sup> [REDAKTUAR]<sup>150</sup> [REDAKTUAR]<sup>151</sup> [REDAKTUAR]<sup>152</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	<p>[REDAKTUAR].<sup>153</sup></p> <p>Një anëtar i UÇK-së i ra [REDAKTUAR] me shkelm, duke ia thyer dhëmbët [REDAKTUAR].<sup>154</sup></p> <p>[REDAKTUAR] i thanë që ta rrihte [REDAKTUAR] me shkop sepse ishte serb.<sup>155</sup></p> <p>Gjatë rrahjes së parë të përshkruar më lart, anëtarët e UÇK-së i kërkuan [REDAKTUAR] që të shkruante në letër emrat e miqve të tij në MPB.<sup>156</sup> Në atë rast, Sabit GECI e pyeti [REDAKTUAR] nëse kishte punuar për serbët.<sup>157</sup> Ai beson se së paku një i ndaluar mbahej dhe keqtrajtohej për shkak se u kishte dhënë armë forcave serbe.<sup>158</sup></p> <p>Gjatë ndalimit [REDAKTUAR] nga UÇK-ja në Durrës, [REDAKTUAR] u akuzua nga anëtarë të UÇK-së se nuk kishte kontribuar në fondin e UÇK-së.<sup>159</sup></p>
(3) Synimi i shkaktimit të dhimbjes ose vuajtjes së rëndë.	<p>Synimi i <b>Pjetër SHALËS</b> për të shkaktuar dhimbje ose vuajtje të rëndë duket qartë nga mënyra e qëllimshme si u rrahën dhe keqtrajtuat të ndaluarit, lloji i mjeteve që u përdorën (ndër të cilat shufra hekuri, shkopinj të trashë, shkopinj bejsbolli, thika dhe armë), kërcënimet me lëndim ose vrasje, dhe vazhdimi dhe përshkallëzimi i keqtrajtimit me gjithë lëndimet e dukshme të të ndaluarve. Shih më lartë elementin 1 dhe 2 të <b>Pikës 2</b>.</p>
(4) Viktima është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	<p><i>Shih më lart, elementi 3 i <b>Pikës 1</b>.</i></p>

<sup>153</sup> [REDAKTUAR]<sup>154</sup> [REDAKTUAR]<sup>155</sup> [REDAKTUAR]<sup>156</sup> [REDAKTUAR]<sup>157</sup> [REDAKTUAR]<sup>158</sup> [REDAKTUAR]<sup>159</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

(5) Dijenia se viktimat është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	<i>Shih më lart</i> , elementi 4 i <b>Pikës 1</b> .
<b>Pika 4: Vrasje e paligjshme (neni 14(1)(c)(i))</b>	
(1) Veprim ose mosveprim që ka për pasojë vdekjen e një individi.	<p>Rreth datës 4 qershor, <b>Pjetër SHALA</b>, Sabit GECI, Xhemshit KRASNIQI dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së rrahën [REDAKTUAR], ndër të tjera me shufra metali, shkopinj bejsbolli dhe armë.<sup>160</sup> Anëtarët e UÇK-së qëlluan nga afër [REDAKTUAR] me armë zjarri.<sup>161</sup> [REDAKTUAR].<sup>162</sup> Pasi u qëlluan me armë zjarri, [REDAKTUAR] u rrahën.<sup>163</sup></p> <p>Pas rrahjeve dhe gjuajtjes me armë zjarri, anëtarët e UÇK-së e çuan [REDAKTUAR] në një dhomë ku mbahej [REDAKTUAR].<sup>164</sup> [REDAKTUAR] kishte një vrimë plumbi [REDAKTUAR] dhe ishte i mbuluar në gjak.<sup>165</sup> [REDAKTUAR]<sup>166</sup></p> <p>[REDAKTUAR] “vuajti pothuajse 24 orë dhe vdiq në mëngjes.”<sup>167</sup> Megjithëse kërkoi t’i sillnin mjek, [REDAKTUAR] u vizitua nga personeli mjekësor vetëm para se të vdiste.<sup>168</sup> “Mjeku kërkoi që ta sillnin – ta çonin në spital në Kukës, dhe ata nuk e çuan – nuk u pajtuan.”<sup>169</sup> [REDAKTUAR]<sup>170</sup> [REDAKTUAR] vdiq me kokën mbështetur te [REDAKTUAR].<sup>171</sup></p>

<sup>160</sup> [REDAKTUAR]<sup>161</sup> [REDAKTUAR]<sup>162</sup> [REDAKTUAR]<sup>163</sup> [REDAKTUAR]<sup>164</sup> [REDAKTUAR]<sup>165</sup> [REDAKTUAR]<sup>166</sup> [REDAKTUAR]<sup>167</sup> [REDAKTUAR]; *shih gjithashtu* [REDAKTUAR]<sup>168</sup> [REDAKTUAR]<sup>169</sup> [REDAKTUAR]<sup>170</sup> [REDAKTUAR]<sup>171</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	Anëtarët e UÇK-së “e nxorën duke e tërhequr zhagas, sikurse nxirret zhagas një qen nga dhoma.” <sup>172</sup>
(2) Synimi i vrasjes ose shkaktimit të qëllimshëm të lëndimit të rëndë apo dëmtimit të rëndë fizik që kryesi logjikisht duhet të ketë ditur se kjo mund të kishte për pasojë vdekjen	<p>Synimi i <b>Pjetër SHALËS</b> duket qartë nga pjesëmarrja aktive dhe e rregullt e tij në sulmet e dhunshme kundër të ndaluarve, përfshirë kundër viktimës së vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], deri në dhe duke përfshirë incidentin kur [REDAKTUAR] u qëlluan me armë zjarri. <b>Pjetër SHALA</b> i sulmonte të ndaluarit me dhunë të një shkalle të tillë sa që ai logjikisht duhet ta ketë ditur se kjo mund të kishte pasojë vdekjen. Për më tepër, gjatë sulmeve të mëhershme (<i>p.sh</i>, më 20 maj, ose rreth kësaj date, dhe [REDAKTUAR]) <b>Pjetër SHALA</b> me vullnet të lirë mori pjesë në sulmet e përbashkëta gjatë të cilave u treguan dhe/ose u përdorën armë zjarri.<sup>173</sup></p> <p>[REDAKTUAR].<sup>174</sup></p> <p>Pas vdekjes së [REDAKTUAR], një anëtar i UÇK-së i ra [REDAKTUAR] me shkelm në kokë [REDAKTUAR].<sup>175</sup> Sabit GECI e rrahu [REDAKTUAR] përsëri, [REDAKTUAR]<sup>176</sup> Një anëtar tjetër i UÇK-së iu drejtua të ndaluarve, përfshirë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], dhe u tha, “Me ju të tre do të merrem sonte.”<sup>177</sup></p>
(3) Viktima është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	<p>[REDAKTUAR] mbahej në ndalim në fabrikën e metalit në Kukës dhe rrjedhimisht nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u qëllua me armë zjarri dhe më pas vdiq.<sup>178</sup></p> <p><i>Shih gjithashtu, elementi 3 i Pikës 1.</i></p>

<sup>172</sup> [REDAKTUAR]<sup>173</sup> *Shih më lart, referencat nën Pikën 2, Trajtim mizor.*<sup>174</sup> [REDAKTUAR]<sup>175</sup> [REDAKTUAR]<sup>176</sup> [REDAKTUAR]<sup>177</sup> [REDAKTUAR]<sup>178</sup> *Shih më lart, referencat nën Pikën 2, Trajtim mizor.*

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

(4) Dijenia se viktima është person që nuk merr pjesë aktive në luftime.	Së paku nga koha e rrahjes që ndodhi më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, ( <i>d.m.th</i> , rreth [REDAKTUAR] para se të qëllohej dhe vritej [REDAKTUAR]), <b>Pjetër SHALA</b> e dinte se [REDAKTUAR] mbahej në ndalim dhe rrjedhimisht nuk merrte pjesë aktive në luftime. <sup>179</sup>  <i>Shih gjithashtu, elementi 4 i Pikës 1.</i>
<b>FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE</b>	
<b>Përgjegjësi për kryerje (neni 16(1)(a))</b>	
(1) Kryerja fizike e krimit ose moskryerja e fajshme e një veprimi të detyrueshëm sipas një rregulle të së drejtës penale	[REDAKTUAR], <sup>180</sup> [REDAKTUAR], <sup>181</sup> dhe [REDAKTUAR] <sup>182</sup> e identifikuan <b>Pjetër SHALËN</b> si kryes të drejtpërdrejtë të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës të së paku nëntë të ndaluarve, afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999. <i>Shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikës 2</b> . Ai mori pjesë në incidentin kur [REDAKTUAR] u rrah, u qëllua me armë zjarri dhe u lëndua për vdekje. <sup>183</sup> <i>Shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikës 4</b> .
(2) Synimi për kryerjen e krimit, ose dijenia për gjasën e konsiderueshme të kryerjes së krimit si pasojë e sjelljes dhe veprimeve të tij	Synimi i <b>Pjetër SHALËS</b> për kryerjen e krimeve të akuzuara apo dijenia e tij për gjasën e konsiderueshme të kryerjes së një krimi si pasojë e sjelljes dhe veprimeve të tij, duken qartë nga pjesëmarrja aktive dhe në vazhdimësi e tij në sulmet kundër viktimave. <i>Shih më lart</i> , elementi 2 i <b>Pikave 1, 2 dhe 3</b> .
<b>NKP (neni 16(1)(a))</b> <sup>184</sup>	

<sup>179</sup> *Shih më lart*, referencat nën Pikën 2, Trajtim mizor.<sup>180</sup> [REDAKTUAR]<sup>181</sup> [REDAKTUAR]<sup>182</sup> [REDAKTUAR]<sup>183</sup> [REDAKTUAR]<sup>184</sup> Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët ('NKP') është formë e kryerjes e përfshirë në nenin 16(1)(a) (shih ngjashëm TPNJ, Krajišnik/Krajishnik, Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit, para.662 (trajton formulim të njëjtë në kontekst të Statutit të TPNJ-së).

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

(1) Shumësi personash	Në funksionimin e qendrës së ndalimit në fabrikën e metalit në Kukës dhe sulmet kundër të ndaluarve u përfshinë disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët <b>Pjetër SHALA</b> , Xhemshit KRASNIQI, Sabit GECI, “[REDAKTUAR]. <sup>185</sup>
(2) Ekzistenca e një plani, projekti apo qëllimi të përbashkët që përbën ose përfshin kryerjen e krimit.	Qëllimi i përbashkët i marrjes në pyetje dhe keqtrajtimit të personave që mbaheshin në ndalim në fabrikën e metalit në Kukës duket qartë nga veprimet dhe sjelljet e <b>Pjetër SHALËS</b> dhe anëtarëve të tjerë të UÇK-së të cilët në mënyrë të paligjshme ndaluan dhe keqtrajtuan viktimat në fabrikën e metalit në Kukës për një periudhë të zgjatur, duke përfshirë raste të shumta të marrjes në pyetje dhe dhunës. <i>Shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .
(3) Kontribut i qenësishëm në planin/projektin e përbashkët.	<b>Pjetër SHALA</b> dha kontribut të qenësishëm në planin/projektin e përbashkët përmes veprimeve dhe mosveprimeve të tij, si pjesëmarrja në transportimin e një të ndaluarit për në fabrikën e metalit në Kukës; <sup>186</sup> pjesëmarrja e tij në rrahjet e të ndaluarve; ndihma dhe mbështetja prej tij e anëtarëve të tjerë të UÇK-së që morën pjesë në sulmet kundër të ndaluarve; dhe mosmarrja prej tij e masave për garantimin e trajtimit njerëzor të të ndaluarve.  <i>Shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .
(4) Synimi për realizimin e qëllimit të përbashkët dhe kryerjen e krimeve.	Synimi i <b>Pjetër SHALËS</b> mund të deduktohet nga pjesëmarrja aktive dhe në vazhdimësi e tij në sulmet kundër të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës.  <i>Shih më lart</i> , elementi 2 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .
(5) Ishte e parashikueshme për të se krimi mund të kryhej prej një anëtari të NKP-së ose	Ishte e parashikueshme për <b>Pjetër SHALËN</b> se një i ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës mund të vdiste si pasojë e sulmeve në të cilat mori pjesë <b>SHALA</b> ; gjatë gjithë periudhës që

<sup>185</sup> Shih p.sh. [REDAKTUAR]<sup>186</sup> [REDAKTUAR]



Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

<p>një tjetri që vetë nuk ishte anëtar por përdorej nga një anëtar i NKP-së për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe i akuzuari me vullnet të lirë mori përsipër rrezikun se krimi mund të ndodhte përmes pjesëmarrjes së tij në NKP.</p>	<p>mbulon Aktakuza, kundër të ndaluarve u përdor dhunë e skajshme, dhe anëtarët e NKP-së dhe/ose ata që vetë nuk ishin anëtarë por përdorshin nga anëtarët e NKP-së, mbanin me vete armë zjarri dhe dukeshin të gatshëm t'i përdornin. Marrja përsipër me vullnet të lirë prej <b>SHALËS</b> e rrezikut që një i ndaluar mund të vritej, duket qartë nga pjesëmarrja në vazhdimësi e tij në sulmet tejet të dhunshme kundër të ndaluarve, si edhe nga dijenia e tij se anëtarët e UÇK-së që merrnin pjesë në ato sulme mbanin me vete armë zjarri.</p> <p>Gjatë transportimit të [REDAKTUAR] për në qendrën e ndalimit në fabrikën e metalit në Kukës, njëri nga ushtarët e UÇK-së që ishte në automjet bashkë me <b>Pjetër SHALËN</b> “nxirrte revolen, nxirrte plumbin, luante me të, dhe ndërkohë, duke luajtur gjithë kohës me revolen, më bënte pyetje.”<sup>187</sup> Më vonë, gjatë rrahjeve që u kryen më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, ku ishte i pranishëm edhe <b>Pjetër SHALA</b>, [REDAKTUAR] u godit me armë dore në kokë.<sup>188</sup></p> <p>Gjatë periudhës që [REDAKTUAR] mbahej në ndalim, Xhemshit KRASNIQI kishte armë dore gjatë gjithë kohës.<sup>189</sup> Gjatë rrahjeve kur [REDAKTUAR] u qëllua për vdekje dhe në të cilat mori pjesë <b>Pjetër SHALA</b>, të pranishëm ishin edhe ushtarë të tjerë të panjohur që kishin revole në brez.<sup>190</sup></p> <p>Në lidhje me marrjen përsipër të rrezikut me vullnet të lirë prej <b>SHALËS</b> se një i ndaluar mund të vritej, [REDAKTUAR] deklaroi që <b>SHALA</b> i tha “Do të të vrasim, do të ekzekutojmë.”<sup>191</sup> Edhe anëtarë të tjerë të NKP-së i kërcënuan me vrasje të ndaluarit në mënyrë të përsëritur. [REDAKTUAR]<sup>192</sup></p>
---	---

<sup>187</sup> [REDAKTUAR]<sup>188</sup> [REDAKTUAR]<sup>189</sup> [REDAKTUAR]<sup>190</sup> [REDAKTUAR] . *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].<sup>191</sup> [REDAKTUAR]<sup>192</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	Përveç kësaj, <i>shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .
<b>Ndihmë dhe inkurajim (neni 16(1)(a))</b>	
(1) Sjellje dhe veprime që përbëjnë praktikisht ndihmë, inkurajim ose mbështetje morale.	Veprimet dhe mosveprimet e <b>Pjetër SHALËS</b> , si pjesëmarrja e tij në transportimin e një të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës; <sup>193</sup> pjesëmarrja e tij në rrahjet e të ndaluarve; ndihma dhe mbështetja prej tij e anëtarëve të tjerë të UÇK-së që merrnin pjesë në sulmet ndaj të ndaluarve; dhe mosmarrja prej tij e masave për garantimin e trajtimit njerëzor të të ndaluarve, përbënin praktikisht ndihmë, inkurajim ose mbështetje morale.  <i>Shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .
(2) Që ka ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e një krimi.	Kontributi moral dhe fizik i <b>Pjetër SHALËS</b> pati ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve. Lidhur me kontributin moral të <b>SHALËS</b> në kryerjen e krimeve, [REDAKTUAR] deklaroi se “ <b>Pjetër SHALA</b> ishte një epror, si në të parën – pikën e parë. [REDAKTUAR]. Kjo – ata ishin një zinxhir i vogël, pra ishin të lidhur me njëri-tjetrin dhe askush nuk guxonte t’ua kthente fjalën apo urdhrat. Duhet të kuptojmë kush ishte shok i ngushtë dhe me kë, për të kuptuar se nuk guxon ose kush guxon t’ia kthejë fjalën [ <i>sic</i> ].” <sup>194</sup> Ai më tej deklaroi se mjekët që punonin në fabrikën e metalit në Kukës nuk do të kishin guxuar t’u ofronin ndihmë mjekësore të ndaluarve pa urdhrin e Sabit GECIT, Xhemshit KRASNIQIT apo <b>Pjetër SHALËS</b> . <sup>195</sup>  Lidhur me kontributin fizik të <b>SHALËS</b> në kryerjen e krimeve, [REDAKTUAR] deklaroi se <b>Pjetër SHALA</b> “ishte goxha trupmadh, i fortë, i fuqishëm, dhe u binte njerëzve në një mënyrë – në një mënyrë si u bien njerëzit kafshëve, por nuk sillen ashtu me njerëz të tjerë. Nuk rrihen njerëzit në atë mënyrë.” <sup>196</sup>

<sup>193</sup> [REDAKTUAR]<sup>194</sup> [REDAKTUAR]<sup>195</sup> [REDAKTUAR]<sup>196</sup> [REDAKTUAR]

Publike

Përmbledhje e detajuar në bazë të rregullës 86(3)(b)

	Ndërkohë, [REDAKTUAR] i përshkroi rrahjet që <b>Pjetër SHALA</b> u bëri [REDAKTUAR] të ndaluarish: "I rrahu aq keq sa u shkatërruan ... I rreshtonte në oborr dhe i rrihte." <sup>197</sup> Përveç kësaj, <i>shih më lart</i> , elementi 1 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .
(3) Dijenja se sjellja dhe veprimet ndihmojnë në kryerjen e krimit nga kryesi.	Dijenja e <b>Pjetër SHALËS</b> se sjellja dhe veprimet e tij ndihmuan në kryerjen e krimeve të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, mund të deduktohet nga pjesëmarrja aktive dhe në vazhdimësi e tij në mbajtjen e të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës dhe në aktet e dhunës kundër tyre.  Shih më lart, elementi 2 i <b>Pikave 1, 2, 3 dhe 4</b> .

---

<sup>197</sup> [REDAKTUAR]